



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0061628-7/24 dt. 23.09.2024

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 49, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit; 2, paragrafi 2.1 ndërlidhur me neni nt 4,5,6 dhe 7 të ligjit nr 04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional; vendimin e MASHT-it nr 2/3726 të dt 28.08.2019 neni 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 23.09.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për miratimin e ndryshimit të emërtimeve të Shkollave të Mesme Profesionale SHMLM “Xheladin Deda”, SHMLE “Hasan Prishtina” dhe SHMLT “Arkitekt Sinani” nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale në Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional-IAAP

1. Me këtë vendim Shkollat e Mesme Profesionale në Mitrovicë të Jugut SHMLM “Xheladin Deda”, SHMLE “Hasan Prishtina” dhe SHMLT “Arkitekt Sinani” nga Shkollat të Mesme të Larta Profesionale EMËRTOHEN Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional - IAAP.
2. Ndryshimi i emërtimeve të tri shkollave sipas pikës 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të rregullimit, strukturimit, organizimit dhe menaxhimit të Institucioneve të cilat ofrojnë arsim dhe aftësim profesional sipas Ligjit Nr. 04/L-138 Për arsimin dhe aftësimin profesional si dhe akteve tjera ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtorja për Arsim.
4. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

